



Profesioni Ligjor ne Shqiperi

Seminar I CCBE dhe DHKA *“Vlerat Themelore te Profesionit Ligjor dhe Mekanizmat e Zbatimit”*

Prof. Dr. Maksim R. HAXHIA, Kryetar I DHKA

Baza ligjore

- ▶ Veprimtaria e Avokatisë Shqiptare ka marrë profilin e saj të mirëfilltë dhe modern në periudhën e themelimit të shtetit shqiptar të pavarur me shpalljen e pavarësisë më 28 Nëntor 1912
- ▶ Ky profil u materializua ligjërisht me miratimin e ligjit të parë shqiptar mbi organizimin e avokatisë më 30 dhjetor 1922, ligj i cili u përmirësua gjatë kohës në vazhdim;
- ▶ Institucioni i avokatisë u suprimua gjatë periudhës së diktaturës komuniste (1967 – 1990);
- ▶ Në fillimin e viteve '90 filloi puna për ngritjen e tij, e cili u bë e mundur me ligjin nr. 7541, datë 18.12.1991 “Për avokatinë në R.SH;
- ▶ Krijimi i bazës ligjore të profesionit të avokatit sipas standardeve bashkëkohore dhe organizimi i strukturave të avokatisë në qendër dhe në rrethe u krijuan në vitin 2003-2005, me miratimin e ligjit nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ndryshuar me ligjin nr. 9795, datë 23.7.2007; ligjin nr.10 047, datë 24.12.2008 dhe ligjin nr. 91/2012, datë 27.09.2012.)
- ▶ Statuti i DHKA i miratuar me 10 Prill 2005 nga Këshilli i Përgjithshëm i DHKA dhe Kodi Etik i Avokatit, i miratuar me vendimin nr. 31, datë 12 Nëntor 2005 nga Këshilli i Përgjithshëm i DHKA e plotësuan kornizën ligjore të rregullimit të profesionit të avokatisë në shqipëri

Ushtrimi I profesionit te avokatit

- ▶ Profesionin e avokatit mund ta ushtrojë çdo shtetas shqiptar i cili:
 - i) pajiset me lejen (licencën) e ushtrimit të profesionit sipas procedurës së përcaktuar në nenin 25 të ligjit nr. 9109/2003, i ndryshuar dhe ii) regjistrohet në organet tatimore;
 - ii) Për sa i takon marrjes së lejes përkatëse për profesionin e avokatit kërkohet përmbushja e disa kriterëve thelbësorë, të parashikuara në ligjin nr. 9109/2003, i ndryshuar realizimi i të cilave mbikëqyret nga ana e organeve drejtuese të DHKA;
 - iii) Gjatë ushtrimit të profesionit të tij avokati duhet të identifikohet me numrin e lejes së ushtrimit të profesionit, si dhe me kodin fiskal të tij apo të zyrës ku ai bën pjesë. Përveç numrit unik të lejes së ushtrimit të çdo avokati, ky i fundit duhet të paraqesë përpara organeve kompetente kartën e identitetit të avokatit, e cila sipas rregullave të vendosura në Statutin e DHKA, i jepet avokatit çdo vit pasi ai ka paguar rregullisht detyrimet e anëtarësisë.



Organet e DHKA

- ▶ Aktualisht, DHKA ka ngritur 13 dhoma lokale të avokatisë në rrethe;
- ▶ Organet drejtuese të DHKA-së dhe të dhomave të avokatisë janë, përkatësisht:
 - ▶ Këshilli i Përgjithshëm dhe
 - ▶ Këshilli Drejtues;
- ▶ Struktura të tjera të DHKA:
 - ▶ Komiteti Disiplinor i Avokateve;
 - ▶ Shkolla Kombëtare e Avokatisë;
 - ▶ Revista Periodike “Avokatia”



Baza Ligjore

- ▶ DHKA ne bashkepunim me Lord Slynn Foundation of Hardley dhe Këshillin e Barit të Anglisë dhe Wells, zbatuan Projektin “Për përmirësimin e bazës ligjore dhe institucionale të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, me fokus të veçantë zbatimin e rregullave të etikës nga avokatët”;
- ▶ Produkti final I ketij projekti jane ndryshimet e fundit ligjore të datës 27/09/2012, të cilat iu bënë ligjit nr. 9109/2003 “Per Profesionin e avokatit ne RSH”, i ndryshuar, duke parashikuar struktura te reja disiplinore dhe nje procedure teresisht te re te procedimit disiplinor per shkeljen e rregullave te etikes si dhe cilesise se sherbimit nga ana e avokateve.
- ▶ Gjithashtu nje tjeter ndryshim I rendesishem kishte te bente me rregullat e procedurat lidhur me formimin profesional të avokateve por edhe percaktimin si detyrim ligjor te trajnimit fillestar per kandidatet per avokate, i cili tashmë realizohet prej 3 vitesh nga një strukturë e specializuar si Shkolla Kombëtare e Avokatisë;

Anetarsimi ne PECO/CCBE

- ▶ Sot ne Regjistrin Kombetar te avokateve jane te regjistruar 8700 avokatë (aktivë dhe pasivë) nga të cilët 2200 janë avokatë që ushtrojnë profesionin në mënyrë active;
- ▶ DHKA është pranuar si Anëtare me statusin e vëzhguesit në Keshillin e Bareve dhe Shoqatave ligjore ne Europe, CCBE, në datën 24 Maj 2008, Hungari;
- ▶ Me anëtarësimin në CCBE, DHKA ka aderuar në Kartën e Parimeve Themelore të Profesionit Ligjor në Europë dhe Kodin e Sjelljes së Avokatëve Europeanë, në themel të të cilave qëndrojnë respektimi i parimeve të rëndësishme, ku ndër të tjera janë: etika, profesionalizmi, mbrojtja e interesave te klientit, shmangja e konfliktit te interesit, respekti per gjykatën dhe shtetin ligjor, etj;
- ▶ Zbatimi I ketyre parimeve dhe mekanizmat e ngritur nga DHKA per kete qellim eshte tema e seminarit te sotem e organizuar nga koleget tane te PECO, structure e CCBE, e cila mbeshtet profesionet ligjore jo vetem ne vendet e BE por edhe ne vende si Shqiperia qe aspirojne anetarsimin e shpejte ne BE;

Anetarsimi ne PECO/CCBE

CCBE dhe PECO e kane mbeshtetur DHKA ne disa drejtime dhe sfida qe kemi patur me qeverine dhe organe te tjera te ekzekutivit, duke permendur nder te tjera:

- ▶ Kundershtimin e vendosjes se kasave fiskale dhe TVSH;
- ▶ Ndryshimet ne ligjin e avokatisë ne vitin 2009 qe kishin te benin me nderhyrjen ne autonome e DHKA apo me reduktimin e kuotes se anetarsise ne menyre qesharake ne 1 euro;
- ▶ Rritjen e kontributit per sigurimet shoqerore dhe shendetsore te avokateve , etj
- ▶ DHKA e ka fituar betejen ligjore ne Gjykatën Kushtetuese, ku kjo efundit ne vendimin Vendim nr. 7, datë 12.03.2010 ka përcaktuar që: “[...] në parim, ligjbërësi lejohet të rregullojë profesionin e avokatit për çështje të interesit publik. Megjithatë, rregullimi/ndërhyrja nuk duhet të cenojë autonominë e profesionit”;



Te reja

- ▶ Edhe ligji per sigurimet shoqerore dhe shendetsore I atakuar se fundmi ne Gjykatën Kushtetuese, u shpall ne kundërshtim me kushtetuten nga kjo gjykate sa I takon rritjes se kontributit te ketyre sigurimeve lidhur me pjesen e avokateve;
- ▶ Me kenaqesi dua te informoj kryesisht koleget e CCBE se ne kuader te Reformes ne drejtesi, ku DHKA ka qene e perfshire qysh prej fillimit te procesit, eshte parashikuar se avokatet do te kene nga 2 perfaqesues ne strukturat ekzekutive te gjyqsorit, perkatesisht ne Keshillin e Larte Gjyqsor si dhe ne Keshillin e Larte te Prokurorise;
- ▶ Gjithashtu shume shpejt pritet te miratohet ligji I ri I avokatise – I cili per shkak te ndryshimeve te herepashershme u pa nevoja te rishkruhet duke permirsuar ceshtje qe kane dale nga praktika e deritanishme



Vlerat themelore te profesionit ligjor

- Dua te pergeztoj organizatoret e CCBE lidhur me perzgjedhjen e temes se ketij seminari dhe punen per realizimin e tij;
- Nje rendesi te vecante merr kjo teme kur flitet per avokatet shqiptare, shumices se te cileve ne kushtet e mbijeteses i duhet te luftojne per te permbushur detyrimet ligjore dhe morale ndaj:
 - klientit;
 - gjykatave dhe institucioneve te tjera
 - profesionit ligjor ne pergjithesi dhe cdo anetari te tij ne vecanti;
 - publikut, per te cilin ekzistenca e nje profesioni te lire dhe te pavarur, eshte nje element esencial per te mbrojtur te drejtat e njeriut perballe pushtetit te shtetit dhe interesave te tjera te shoqerise.



Korpusi Avokatia

- Dhe se fundmi duke ju uruar te gjithë folesve dhe pjesemarresve pune te mbare ju ftoj te shikoni dhe kete minifilm qe tregon rrugen nga praktikimi I profesionit ligjor ne kafenete e Tiranes ne ofrimin e ambienteve te Korpusit “Avokatia” gjithë avokateve shqiptare”;

Faleminderit!